

Udhëzues për përgatitjen efektive të kolonoskopisë tuaj

Informacione, udhëzime dhe përgjigje për pyetjet tuaja


E nderuara paciente! I nderuari pacient!

Ju jeni regjistruar për të kryer një kolonoskopi në klinikën tonë. Për kryerjen me sukses të kolonoskopisë kushti themelor është që zorra të jetë e pastër. Për këtë ju keni marrë nga ne një skemë përgatitje. Më këtë broshurë ne dëshirojmë t'ju japim disa këshilla në mënyrë që përgatitjet tuaja për kolonoskopinë të janë mundësisht sa më efektive dhe zbrazja të sigurojë një zorrë të trashë të pastër për ekzaminimin. Kjo broshurë u përpilua në bazë të informacioneve të dhëna nga pacientët të cilët e kishin kryer më parë një kolonoskopi. Ato u pyetën në lidhje me paqartësitë dhe vështirësitë eventuale në lidhje me përgatitjen. Ju lutemi lexojeni këtë broshurë.

Përse është e rëndësishme për ekzaminimin që zorra të jetë e pastër?

Qëllimi i kolonoskopisë është zbulimi i dëmtimeve (si p.sh. polipe, tumore). Për këtë është vendimtar një gjykim i sigurt i mukozës së zorrës. Nëse zorra është e ndotur me papastërti jashtëqitje atëherë do të realizohet një ekzaminim më i gjatë dhe më i pakëndshëm. Në rastin e papastërtive që nuk mund të lahen duhet madje të planifikohet një takim tjetër për ekzaminimin me një zbrazje tjetër.

Një zorrë e trashë e pastër do të thotë për ne një udhëtim mbi një rrugë në mot me diell. Dhe në kontrast me këtë është një zorrë e trashë e papastër si një udhëtim në një stuhi bore.



Zorrë e trashë e pastër



Zorrë e trashë e papastër

Si pastrohet zorra juaj e trashë?

Për procedurën e zbrazjes së zorrës ju keni marrë një udhëzim të detajuar. Për përgatitjen optimale të zorrës janë të rëndësishme dita para ekzaminimit dhe dita pas ekzaminimit. Këtu ju gjeni në formë skice të përmbledhur se çfarë duhet të bëni në këto ditë:

Ditën PARA ekzaminimit



Ushqim

08:00: 2 tableta Dilcolax

Nga tani vetëm lëng të kthjellët
Mos përdorni produkte ushqimor të fortë



Pije

4 gota me lëng të kthjellët



12:00: Përgatitja e zorrës me Picoprep, qeska e 1-rë

Duke filluar nga tani duhet të qëndroni në afërsi të një tualeti

12:30-16:30: çdo orë minimumi ½ Litër lëng të kthjellët



18:00: Përgatitja e zorrës me Picoprep, qeska e 2-të

18:30-22:30: çdo orë minimumi ½ Litër lëng të kthjellët



Dita e ekzaminimit



Ushqim

Vetëm lëngje të kthjellëta në çdo sasi. Nuk lejohen produktet e forta ushqimore



Pije

lëng i kthjellët



Ekzaminimi

Ushqim normal




lëng i kthjellët



Ushqim normal




Si ta përgatisni tretësirën me Picoprep për zbrazjen e zorrës së trashë?

Mbushni një gotë me 150 ml ujë të ftohtë



Boshatisni përmbajtjen e qeskës në gotë



Përziëni për 2-3 minuta. **Nuk lejohen grumbullime në fundin e gotës.**

Pijeni Tretësirën.

Nëse ju pëlqen më shumë, tretësirën e ngjashme me qumështin mund ta pini të ftohtë.



Pini **½ Litri lëng të kthjellët në çdo orë, për 4 orë rresht**

Çfarë do të thotë lëng i kthjellët?

Siç edhe e keni lexuar më parë, ju duhet të pini vetëm „lëng të kthjellët“ gjatë përgatitjes për ekzaminimin. Këtu gjeni disa këshilla, se çfarë mund të konsumoni.



Është lëng portokalli. Ju NUK lejoheni ta konsumoni atë.



Është lëng ananasi. Ju NUK lejoheni ta konsumoni atë.



Është lëng molle. Ju lejoheni ta konsumoni atë.

Ato çfarë lejoheni ende të pini janë



Shurup me ujë soda



Ujë mineral



Kafe pa qumësht



Pije energjike izotonike



Lëng molle



Çaj pa qumësht

Çfarë NUK duhet të pini?

Kafe me qumësht



Qumësht



Milk shake

Normalisht pijet alkoolike janë pije të kthjellëta, por duhet të mënjanohen gjatë përgatitjes së zorrës, duke qenë se ato mund të çojnë në tharje.

Çfarë mund të hani gjatë përgatitjes së zorrës?



Mjaltë



Supë e kthjellët



Akullore me shkop



Karamele të forta

Çfarë NUK lejohet të hani gjatë përgatitjes së zorrës?



Bukë, Brumëra të pjekura, Makarona



Supë me të grira



Produkte mishi



Djath dhe produkte qumështi



Perime



Fruta

Si mund ta merrni vesh që përgatitja e zorrës është e suksesshme?

Ju duhet të kontrolloni jashtëqitjen nëse është ashtu siç keni ngrënë dhe keni pirë, që do të thotë e kthjellët dhe pa përbërës të fortë. Ju duhet të jeni i sigurt që përgatitja e zorrës ishte e suksesshme nëse jashtëqitja është në të verdhë, e lëngshme dhe e kthjellët.



E errët
dhe
e turbullt

**Nuk është
ende mirë**

Kafe
dhe
e turbullt

**Nuk është
ende mirë**

Kafe e hapur
dhe
e turbullt

**Nuk është
ende mirë**

Ngjyrë portokalli
dhe kryesisht
e kthjellët

**Pothuajse
e saktë**

E verdhë dhe
e kthjellët si
urina

E SAKTË